



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Datë, 20.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjan, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **18.11.2019**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik SH.P.K Avag Group, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa perendimore Llot 3**”, me Nr. të Prok: **613-19- 7650- 221** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të SH.P.K Avag Group, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa perendimore Llot 3**”, me Nr. të Prok: **613-19- 7650- 221** Nr. Brendshëm 613 019 091 221 kundër [Vendimit për dhënie të Kontratës të AK –së, të datës 11.11.2019 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Vërtetohet** vendimi i AK për **dhënien e kontratës** publikuar me datë: **11.11.2019**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*
Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik SH.P.K Avag Group me datë 18.11.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa perendimore Llot 3**, me Nr. të Prok: **613-19- 7650- 221** Nr. Brendshëm 613 019 091 221. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.11.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesë e juaj për rishqyrtim, është e pabazuar, ku me të drejte AK, ofertën e juaj e ka shpallur me gabime aritmetikore më shumë se 2% siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi të prokurimit

publik. Pretendimi i juaj nuk qëndron për arsye se te përshkrimi i çmimeve në pozicionin 1 shkruan shumë qartë se duhet të ofertohej për m² edhe njësia është m²

Përshkrimi i çmimeve te pozicioni nr 1 është si vijon më poshtë:

Vërejtje: me këtë pozicion duhet të jepet qmimi per m² për Largimin e borës si dhe hedhjen e kripës 20gr per m2 per nje intervenim sipas specifikimeve per mirmbajtjen e një m² të rrugës në ditët kur ka të reshura- Mirëmbajtja të llogaritet për një sezon 15. Nëntor 2019 deri 31.Mars 2020 i cili mund te jene deri ne 20 intervenime.

Shifni tabelën me përshkrime për pozicione të caktuara, me fokusime në pretendimet e juaja:

Poz	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi per 1 (një) herë e hudhjes se kripes per (m ²)	Çmimi per 20 herë e hudhjes se kripes per (m ²)	Totali
	Largimi i borës nga rrugët sipas specifikacioneve të parapara me aktivitete. a) largimi I borës nga rruga. b) hedhja e kripës me rërë. Verejtje: me këtë pozicion duhet te jepet qmimi per m ² për Largimin e borës si dhe hedhjen e kripës 20gr per m2 per nje intervenim sipas specifikimeve per mirmbajtjen e një m ² të rrugës në ditët kur ka të reshura- Mirëmbajtja të llogaritet për një sezon 15.Nëntor 2019 deri 31.Mars 2020 i cili mund te jene deri ne 20 intervenime	m ²	597,640	1350	16,136,280.000	

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se mund te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas ngarkimit te ketij Vendimi në E-prokurim.

Prokurimit

